Technical Secretariat of the
National Water Council

# PLANI I MENAXHIMIT TË BASENIT TË LUMIT VJOSË

# IDENTIFIKIMI DHE DIAGNOSTIKIMI I SITUATËS AKTUALE

VLORE, 28 QERSHOR 2018

# SITUATA

## ➢Statusi i projektit

- ❑Data e firmosjes së studimit është mars 2015;
- ❑Studimi është grant i agjencisë franceze të ujit;
- ❑Baseni ujor Vjosë konsiderohet hapsirë ndërkufitare.
- ❑Ky studim është mbështetur në dokumentet ekzistuese dhe të dhënat historike për menaxhimin e basenit ujor Vjosë.
- ❑Raporti paraqet një analizë ekzistuese të cilësisë së ujit, biodiversitetit si dhe aspektit ekonomik dhe ndikimi i aktivitetit njerëzor në basen;
- ❑Statusi ekologjik i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, sipas analizave fiziko – kimike, referuar të dhënave të vitit 2013 është "I moderuar" / "I mirë". Ky status qëndron brenda standartit të kërkuar nga BE;

# QELLIMI

- Hartimi i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Vjosë në përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit.
- Nxjerrja në pah e përparësive dhe mangësive të këtij projekti;
- Përputhshmëria e kapitujve të planit të menaxhimit sipas udhëzimeve të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit.

# KARAKTERISITKAT GJEOGRAFIKE




- ❑ Pellgu ujëmbledhës i lumit Vjosa fillon që nga malet e Pindit (në Greqinë veriore) dhe vazhdon me zonën malore të Leskovikut, Përmetit, Gjirokastrës, Tepelenës, Mallakastrës. Rrjedhja e poshtme e tij nga ana administrative i përket qarkut të Fierit dhe Vlorës.
- ❑ Sipërfaqja ujëmbledhëse e këtij lumi është 6710 km2, nga këto 4365 km2 përfshihen brënda territorit të Republikës së Shqipërisë, kurse pjesa tjetër gjendet në territorin e Greqisë.
- ❑ Lumi Vjosë përbëhet nga degët kryesore të tij si Drinos, Bënça, Luftinja, Shushica si dhe nga një numër i madh përrenjsh të mëdhenj e të vegjël.
- ❑ Vjosa derdhet në detin Adriatik në afërsi të fshatit Poro dhe lagunës së Nartës.




Vjosa - Seman

# VEÇORITË E BASENE NDËRKUFITARE

| Avantazhet | Diavantazhet |
| --- | --- |
| ✓Mundësia për të përgatitur plane menaxhimi në kontekst ndërkufitar sipas DKU-së;<br><br>✓Ngritja e programeve të përbashkëta të monitorimit dhe mundësia e unifikimit të standarteve;<br><br>✓Përfitimet që mund të arrihen nëpërmjet firmosjes së marrëveshjeve të përbashkëta, duke përfshirë menaxhimin e përmbytjeve, ujitjes dhe kullimit, kontrollit të ndotjes, lundrimit, etj;<br><br>✓Shkëmbim eksperience midis institucioneve përkatëse. | ✗ Ndikime negative të industrive të vendeve fqinje;<br><br>✗ Vendosja e standarteve të ndryshme të shkarkimit të ujërave në basen;<br><br>✗ Mund të ketë konkurencë të përdoruesve të ujit, sidomos në kohë thatësirash;<br><br>✗ Nivele ekonomike të ndryshme në rang kombëtar, që mund te ndikojnë në menaxhimin e qëndrueshëm. |

# ANALIZA SWOT

| Pikat e forta (S) | Pikat e dobëta (W) |
|---|---|
| ✓ Plani pilot është në përputhje me DKU<br>✓ Parashikime vetëfinancuese;<br>✓ Përdoren indekset e vëndeve fqinje meqënëse është në kontekst ndërkufitar.<br>✓ Përcakton shkaqet e risqeve të burimeve ujore që karakterizojnë basenet ujëmbledhëse të një vendi; | ✓ Përgjegjësitë midis Prefekturës, Komunave, Bashkive dhe Kompanive të Ujësjellesit;<br>✓ Mungon parashikimi i raportit të VSM-së;<br>✓ Nuk ka marrë parasysh tarifat për shërbimet e ujit;<br>✓ Të dhënat mbi popullsinë i përkasin periudhës 2004-2007;<br>✓ Nuk është realizuar asnjë konsultim me publikun;<br>✓ Ka mungesë të të dhënave historike në lidhje me cilësinë e ujit;<br>✓ Nuk ka bërë përshkrimin e të gjitha rezervat sipërfaqsore ujore dhe rezervat e ujërave nëntokësore;<br>✓ Përcaktimi normativ i gjëndjes së mirë ekologjike i referohet vetëm elementeve biologjikë;<br>✓ Mungon plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet; |
| **Mundësitë (O)** | **Kërcënimet (T)** |
| ✓ Ndihmon në implementimin e DKU;<br>✓ Baza e të dhënave të risqeve mund të rakordohet me bazën e të dhënave të shteteve ndërkufitare (Greqisë), për të realizuar përllogaritje të sakta dhe në kohë reale ndërkufitar; | ✓ Hartimi i planit të plotë kërkon kohë dhe burime financiare;<br>✓ Neglizhimi i konsultave me publikun vonon periudhën e implementimit;<br>✓ Afati kohor i krijimit të të dhënave historike është i gjatë;<br>✓ Nevojitet përgatitje teknike e stafeve për të bërë identifikimin dhe klasifikimin e risqeve. |

# PROBLEMATIKAT

Pjesa më e rëndësishme e përpilimit të një plani menaxhimi të basenit ujor sipas DKU-së është **Programi i Masave**. Përsa i perket planit të menaxhimit të basenit të Vjosës, problematikat kanë të bëjnë me:

- Nga studimi vihet re se është e pamundur të arrihet në një konkluzion për cilësinë e ujit të lumit, duke qenë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme në të gjithë gjatësinë e tij.
- Studimi konkludon se analiza e parametrave biologjik mungon dhe është parashikuar të realizohet në një fazë të mëvonëshme të projektit.
- Mungojnë masat që duhen marrë për parandalimin nga ndotja që shkaktohet nga aktiviteti njerëzor.
- Është bërë identifikimi i presioneve në basenin e Vjosës. Nuk del e qartë cili është impakti në mjedis dhe burimet natyrore, siç kërkohet sipas Direktivës.

# PROBLEMATIKAT

- Plani i Menaxhimit të Përmbytjeve mungon.
- Mungesa e një plani për përfshirjen e palëve të interesuara, informimin me publikun, konsultimin dhe ndergjegjesimin.
- Panvarësisht se statusi ekologjik është paraqitur shumë i mirë përsa i përket nutrienteve (N,P), ky konkluzion i përket periudhës së monitorimit 2004 – 2007 dhe ka nevojë për rishikim.
- Nuk del e qartë cili është ndikimi në mjedis dhe burimet natyrore siç kërkohet sipas Direktivës.
- Nuk është bërë një analizë e detajuar mbi vlerësimin e ndotjes difuzive.

# KONKLUZIONE

- Ky projekt paraqet fazën fillestare të Planit të Menaxhimit të Basenit te Vjosës që konsiston në analizën dhe diagnostikimin e gjendjes ekzistuese / situatës së deri tanishme dhe rekomandimet në bazë të të dhënave të mbledhura në vend, nga institucione të ndryshme dhe nga studime të mëparëshme.
- Materiali duhet të përfshijë dhe të trajtojë kapituj sipas DKU-së në përshtatje me Legjislacionit Shqiptar.
- KBU dhe ABU Mat duhet të marrin pjesë aktive në gjithë procesin e hartimit të planit të ri të menaxhimit të burimeve ujore për basenin e Vjosës, duke përmbushur detyrimet e tyre ligjore në këtë proces.
- Të bëhet një vlerësim teknik dhe ekonomik dhe të sigurohen fonde për përpilimin e një plani të plotë të menaxhimit të basenit. (*Duke iu referuar Vendimit të KKU-së Nr.1 datë 17.2.2015, hartimi i planit të menaxhimit fillon 3 vite përpara përfundimit të planit që është në fuqi*).

Technical Secretariat of the
National Water Council

# FALEMINDERIT!